

Skandali

Qeveria: SAGEM, fitues i tenderit të kartave të identitetit, pavarësisht parregullsive

Ish-Ministri i Pushtetit Lokal Blendi Klosi deklaroi se, "Qeveria mbron një kompani që në rekordet e saj nuk ka asnjë rast të prodhimit të kartave të identitetit. Në asnjë vend të botës nuk ka prodhuar karta identiteti ashtu sic i është kërkuar në termat e referencës që iu kërkuar kompanive të tjera në termat e referencës. Pra, një ID Card Polikarcobanat e personalizuar, të cilën kjo kompani nuk i prodhuar asnjëherë. Kompania nuk ka asnjë nga këto dokumenta që i kërkohej dhe këto i parashtrë dhe në tender. Por, përseri shpallet kompani fituese dhe mbrohet politikisht. Kompania e cila kërkohet të fitojë paraqiti një çmim shumë më të ulët. Në nocionet e ligjit të prokurimeve theksohet "është anomalisht e ulët". Kostoja me të cilën parashikon të realizojë projektin është 50 përqind më e ulët se shumatorja e 7 kompanive të marra së bashku, pra edhe me fituesen


TIRANE –Kompania franceze SAGEM është shpallur fituese e një tenderi të organizuar nga qeveria për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike, por i karakterizuar gjatë periudhës

këtë pretendim. Gjithashtu, gjatë gjithë procedurës së pranimit të dokumentacionit u vu se Komisioni i tenderit kualifikoi firma që nuk plotësonin dokumentacionin e kërkuar në termat e referencës. Këto mangësi pranoheshin



polikarbonat dhe të personalizuar. Kjo është shkelje e kërkesave të tenderit dhe tregon se SAGEM nuk ka mundur aspak që të sigurojë një vend ku të personalizojë plotësisht kartat siç parashikohet nga kërkesat e tenderit me gdhendjen në lazer. Kjo tregohet në pamje filmike dhe në foton bashkëngjitur.

SAGEM nuk ka plotësuar "Kërkesen për Kualifikim", pasi nuk ka arritur të paraqesë "Çertifikatë Sigurie ISO 27000 për sistemet e menaxhimit të sigurisë së lartë.", të kërkuar në kërkesen 23 të pikës 2.3. Certifikata e ISO 27000 e paraqitur i perket një shoqërie tjetër SAGEM-ORGA Gjermani, me ne të cilën SAGEM është aksionere, por që ka personalitet juridik me vehte, dmth ka të drejta dhe detyrime të ndara nga vetë SAGEM. SAGEM-ORGA



favorizuar nga qeveria aktuale.

Ndërsa, Ministri i Brendshëm Bujar Nishani ka deklaruar se, "janë tërësisht trillime deklaratat se kompania "Sagem" nuk ka paraqitur modelin e kartës dhe pasaportës. Çdo dokument i paraqitur nga